

VENDIM
Nr. 125, datë 16.8.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË
HARMONIZUARA TË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT
PËR VITIN 2018 PËR ZYRËN E KOORDINIMIT TË ANKANDEVE TË
KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT NË EUROPËN JUGLINDORE (SEE
CAO)**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 30 dhe nenit 65 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 51 të rregullores së komisionit (BE) 2016/1719, “Për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme (*Forward Capacity Allocation – FCA*)”; nenit 19, pika 1, germa “f” dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për “Fillimin e procedurave për miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Juglindore (SEE CAO)”, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 4111 Prot, datë 26.7.2017, OST sh.a. ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për miratimin e “Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Juglindore (SEE CAO).

- Operatorët e Sistemit të Transmetimit të SEE dhe Zyra e Koordinuar e Ankandit në Evropën Juglindore (SEE CAO) kanë përgatitur një grup të ri rregullash për të zbatuar Rregullat e Harmonizuara të Alokimit të Kapaciteteve të Interkonjeksionit (referuar si HAR), në rajonin e Evropës Juglindore për procesin e ankandit për vitin 2018.

- Rregullorja është hartuar në përputhje me nenin 51 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719, datë 26 shtator, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve të ardhshme (*FORWARD CAPACITY ALLOCATION – FCA*).

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2018 për Zyrën e Koordinimit të Ankandeve të Kapaciteteve të Interkonjeksionit në Evropën Juglindore (SEE CAO).

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti